327,600 klientë individual ose 2% rritje në krahasim me vitin 2020, si rezultat i atraktivitetit të klientëve të rinj.

285,275 kartela Debitore dhe Kreditore të përdorura nga individët, ose -3% ulje në krahasim me vitin 2020, si rezultat i azhurnimit të dhënave të klientëve dhe mbylljes së disa llogarive që nuk kanë pasur qarkullim.

61,298 E-click dhe M-click përdorues individual, ose 17.8% rritje të përdoruesve digjital, krahasuar me vitin 2020.

33 Filiale/ekspozitura, që mbulojnë vendbanimet kryesore në Kosovë.

Bankingu retail 2021 pavarësisht sfidave me të cilat është përballur, ka vazhduar ecurinë dhe suksesin e tij zhvillimor, duke funksionuar sistematikisht në përputhje me strategjinë e blerjeve të bankës dhe standardet më të larta të Grupit NLB. Banka në treg renditet si banka e dytë dhe mbetet si një nga bankat më të mira në fushën e retail në Kosovë me 18.7% të tregut. Krahas aktiviteteve të rregullta të shitjeve në lidhje me aktivitete bankare të retail, fokusi ynë vazhdon të jetë në strategjinë e digjitalizimit dhe fokusimin në projekte të rënda drejt këtij qëllimi. Migrimi i klientëve në kanalet digjitale u mundësua duke krijuar paketa të përshtatshme si një nxitje për efikasitetin e shitjeve dhe përmirësimin e përvojës së klientit. Nga ana tjetër, këshillimi financiar është pjesë plotësuese si e vetmja mënyrë për të mbështetur një rritje të shëndetshme dhe marrëdhënie të qëndrueshme afatgjatë.

Nëpërmjet këtyre përpjekjeve dhe nismave të vazhdueshme, ne kemi arritur të ruajmë bazën tonë të klientëve të retail gjatë vitit 2021, si parakusht për të rritur portofolion kreditore të retail dhe mbështetjen e planeve të investimeve për klientelën e retail, në mënyrë që klientët e retail të blejnë shtëpi dhe të rrisin asetet e familjes së tyre. Janë marrë masa të tjera në drejtim të projektimit të proceseve në kredidhënie për të mbështetur rritjen e pjesës së kreditimit të klientëve. Nëpërmjet proceseve të optimizuara në aktivitetet e klientëve të retail, ne kemi arritur nivele më të larta të kënaqësisë së klientit, të konfirmuar nga sondazhi i matjes së kënaqësisë së klientëve të kryer nga kompania e jashtme.

Rrjeti i degëve: NLB Banka sh.a. është e pranishme në 9 qytete të mëdha përmes 33 njësive organizative që luajnë një rol të rëndësishëm për të qenë sa më afër klientëve. Prania e bankës mbështetet nga opsioni i depozitimit të parave të gatshme në

99 ATM në më shumë se 50% të rrjetit të ATM-ve

Pjesë përbërëse e përpjekjeve për shitje janë fushatat e marketingut që kanë mundësuar jo vetëm komunikim efektiv me publikun e gjerë, por ka pasur edhe formim arsimor sa i përket kanaleve digjitale dhe produkteve të sigurimit bankar. Të gjitha iniciativat e marketingut kanë shfrytëzuar kanale adekuate të marketingut për të depërtuar në treg dhe gjithashtu kanë ndihmuar në rritjen e vlerave të korporatës dhe imazhit të markës së NLB Banka.


Produktet dhe shërbimet e reja – aktivitetet kryesore:

- Banka gjatë vitit 2021 ka lansuar shërbime të reja si në vijim:
- Shërbimi i ri i kanaleve të komunikimeve: Co-browsing.
 - Paguaj mikun – shërbim i ri përmes platformës mobile banking.
 - Ndaj faturën - shërbimi i ri përmes platformës mobile banking.
 - Identifikimi përmes shenjave të gishtërinjve – formë e re dhe e sigurtë e identifikimit e identifikimit në platformën e mobile banking.
 - Autorizimi përmes shenjave të gishtërinjve – formë e re dhe e sigurtë e autorizimit të transaksioneve në platformën e mobile banking.
 - Aplikacioni për menaxhimin e kërkesave online dhe aplikimeve për kredi dhe kartela kreditore përmes webfaqes.
 - Skema e bonusit të lojalitetit – Implementimi i veçorisë për vlerën e shtuar në të gjitha produktet e kartelave kreditore.

Tabela 6. Të dhënat kryesore të aktiviteteve me personat fizik

	2021		
000 EUR	2021	2020	/2020
Shuma e kredive retail (neto)	254,528	215,927	18%
Shuma e depozitave retail	603,710	540,927	12%
Numri klientëve	327,600	321,143	2%
Numri kartelave (debitore)	264,140	271,977	-3%
Numri kartelave (kreditore)	21,135	21,826	-3%
Numri i E-banking	19,138	22,360	-14%
Numri i M-banking	42,160	29,655	42%

Ilustrimi 12. Trendi i kredive dhe depozitave në afarizmin me personat fizik



Kanalet moderne të shpërndarjes

- Banka ka vazhduar të zgjerojë portfolion e përdoruesve të produkteve moderne të kanaleve të pagesave dhe shërbimeve duke prezantuar shërbimet e reja në platformën m-Banking e cila u ofron klientëve tanë mjete të reja inovative dhe të lehta për kryerjen e transfereve, gjë që ka sjellë rritjen e numrit të përdoruesve si dhe kënaqësinë në cilësinë e shërbimeve.
- Platforma m-Banking e Bankës tani ofron për të gjithë përdoruesit e saj opsionin e shërbimit Pay-to-Friend dhe Split-the-Bill duke u mundësuar kështu atyre një mënyrë të shpejtë dhe të lehtë të kryerjes së transaksioneve brenda aplikacionit.
- Si rezultat i zhvillimit të kanaleve elektronike, numri i transaksioneve dhe qarkullimi nga klientët që përdorin kanale moderne të shpërndarjes është rritur vazhdimisht.

- **Tërheqjet në ATM** – kanë shënuar rritje për 11% në volum dhe 6% në numër të transaksioneve.
- **Depozitat në ATM** - gjithashtu kanë shënuar rritje të ndjeshme të përdorimit me shifrat e mëposhtme: 38% në numrin e transaksioneve të depozitave dhe rritje me 54% në vëllimin e transaksioneve të depozitave.
- **Pagesat në POS** – kanë pasur rritje të ndjeshme të përdorimit me shifrat e mëposhtme: 40% rritje në numrin e transaksioneve dhe 47% rritje të vëllimit të transaksioneve.
- **e-Banking** - ka shënuar një rritje prej 0.5% në numrin e transaksioneve dhe 42.7% në vëllimin e transaksioneve.

- **m-Banking** – platforma ka normë edhe më të lartë rritjeje, e cila është 125% në numrin e transaksioneve dhe 196% në vëllimin e transaksioneve.
- **NLB Pay** - Dhe së fundi, por jo më pak e rëndësishme, produkti NLB Pay gjithashtu ka shënuar rritje si në numër ashtu edhe në vëllim të transaksioneve me këto shifra: rritje prej 38% në numrin e transaksioneve dhe rritje prej 59% në vëllimin e transaksioneve.

Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës

Performanca Financiare

Kanalet moderne të shpërndarjes

Risku i likuiditetit


Biznesi dokumentar

Biznesi dokumentar



Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse

Raporti financiar

Ilustrimi 13: Aktivitetet kryesore bankare me persona fizik



Ilustrimi 14. Struktura e kredive të reja të personave fizik sipas produkteve





Ne jemi gjithmonë në dispozicion.

Stërgjyshet paguanin me para në dorë.

Gjyshet paguanin me çeqe.

Nënat paguajnë në mënyrë digjitale.

Çfarë do të sjellë gjenerata e ardhshme?

Në mënyrë që të jemi në një hap me ndryshimet e shpejta globale, ne zhvillojmë zgjidhje me të njëjtat veçori si bota moderne: zgjidhje të shpejta, efikase, të dobishme dhe të mençura. Me zgjidhjet inovative digjitale, ne sigurohemi që të gjitha shërbimet bankare janë të disponueshme kudo, në çdo kohë, dhe në të njëjtën kohë ne përdorim teknologji të avancuar të sigurisë për të ndihmuar në mbrojtjen e privatësisë.

Tregjet financiare dhe operimet me pagesat

Menaxhimi i aktivës dhe pasivës

NLB Banka ka menaxhuar riskun e normës së interesit, likuiditetit dhe kursit të këmbimit me qëllim të menaxhimit të fitimit të qëndrueshëm dhe mbrojtjes së reputacionit të bankës. Ne vazhduam të ndërmarrim veprime për të pasur financim të diversifikuar në të njëjtën kohë duke arritur objektiva të qëndrueshme të likuiditetit. Banka, duke ndërmarrë veprimet e duhura për raportet e likuiditetit, ka mundur të financojë rritjen e kredive. Ne monitorojmë nga afër tregjet vendase dhe ndërkombëtare për të parashikuar çdo luhatshmëri të mundshme të tregut dhe për të minimizuar rreziqet strukturore që lidhen me normat e interesit, pozicionet e likuiditetit dhe këmbimit valutor në bilancin e bankave. Menaxhimi i aseteve dhe detyrimeve ka pasur një rol të rëndësishëm në modelimin e duhur të riskut të normës së interesit dhe likuiditetit, duke raportuar realizimet e fitimit të bankës. Për të ofruar shërbime financiare të qëndrueshme dhe të sigurta për klientët tanë, ne duhet të kemi një menaxhim të fortë dhe gjithëpërfshirës të aseteve dhe detyrimeve, të kemi një financim solid dhe të kemi të gjithë treguesit në përputhje me kufijtë e menaxhimit të riskut. Gjithashtu, banka ka vazhduar të financohet kryesisht nga depozita dhe ne kemi vazhduar përpjekjet tona për të diversifikuar bazën tonë të financimit, kryesisht klientët e retail për të siguruar një bazë të gjerë depozitash. Janë zbatuar strategji për menaxhimin e likuiditetit dhe menaxhimit të riskut, duke përfshirë menaxhimin e likuiditetit brenda ditës dhe menaxhimin e likuiditetit në situata stresuese. Banka ka vendosur dhe monitoron vazhdimisht treguesit e saj të likuiditetit, ku ne kryejmë rregullisht edhe skenarë stresi që i lejojnë bankës të analizojë pozicionet e likuiditetit në rast goditjesh të mundshme, përfshirë ato të brendshme ose të jashtme. Viti 2021 vazhdoi me pandeminë por me rritje ekonomike pozitive, e cila ndikoi pozitivisht në bilancin tonë dhe klientët tanë. Klientët vazhduan besimin e tyre në sektorin bankar për kursimet e tyre dhe për financimin e bizneseve të tyre, ku kemi parë një trend mjaft pozitiv të rritjes si në sektorin e kredive ashtu edhe të depozitave. Sektorin bankar në Kosovë është mbi likuid dhe i

vetë-mjaftueshëm në aspektin e financimit ku depozitat arritën në 4.79 miliardë, ku sektori vazhdon të mbajë raportin kredi ndaj depozitave më pak se 80% në fund të vitit 2021. Si rezultat i mbi likuiditetit marzhet e interesit u ulën më tej në krahasim me vitin e kaluar, edhe pse të ardhurat nga interesi ishin më të larta, por rënia e interesit të kredisë vazhdon. SJP dhe fondet e kostos për bankat në Kosovë mbeten mjaft të ulëta. Gjatë vitit 2021 Banka rriti depozitat e saj me 6.8% dhe portofolin e kredive për klientët me 13%. Banka fokusohet në depozitat e qëndrueshme të retail si bazën e saj kryesore të financimit për aktivitetet kreditore. Asetet dhe detyrimet janë menaxhuar në vazhdimësi duke analizuar risqet e mundshme të likuiditetit valutor, riskun e normës së interesit dhe risqet operacionale në bilanc. Menaxhimi i profitabilitetit vazhdoi duke iu nënshtruar aplikimit të duhur të çmimit të transferimit të fondeve duke vendosur objektiva për linjat e biznesit për të përmbushur objektivat e vendosura.

Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit mund të përkufizohet si risku që rezulton nga mungesa e fluksit të mjaftueshëm monetar për të përmbushur plotësisht detyrimet monetare në kohën e duhur. Risku i likuiditetit përfshin gjithashtu riskun që banka nuk mund të mbyllë pozicionet me çmime të favorshme për shkak të pamundësisë së qasjes në treg. Objektivi i NLB Banka është të ruajë cilësinë e strukturës së aseteve në mënyrë që mjetet likuide të jenë në gjendje të përmbushin të gjitha detyrimet, që nënkupton monitorim të rregullt të raporteve të likuiditetit dhe standardeve për mbajtjen e aseteve me likuiditet të lartë në çdo kohë. Banka ka menaxhuar treguesit kryesorë të likuiditetit mbi limitet minimale të përcaktuara, qoftë nga rregullatorët apo nga aspekti i brendshëm. Në fund të vitit 2021, NSFR (Raporti Neto Stabil i Financimit) ishte mbi 168% dhe LCR (Raporti i Mbulimit të Likuiditetit) ishte 343%. Raporti i likuiditetit vendor që përfshin asetet likuide/detyrimet afatshkurtra ishte 36%, që është i lartë se niveli minimal të kërkuar prej 25%. Rezerva e likuiditetit është e përqendruar kryesisht në mjete monetare, bilanci me Bankën Qendrore, investime të librit bankar si letra me vlerë të qeverisë vendore dhe ndërkombëtare, fonde nostro dhe depozita në

tregun e parasë. Banka është në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Banka Qendrore e Kosovës, e cila përfshin raportet e likuiditetit, përveç kërkesave lokale, banka është në përputhje me Basel III që përfshin raportimin dhe mirëmbajtjen e raporteve LCR dhe NSFR. NLB Banka përdor qasjen e gjerë të grupit për të vlerësuar ndikimin e ngjarjeve të papritura të stresit në pozicionin e likuiditetit. Banka kryen projeksione të flukseve monetare të ardhshme sipas llojeve të ndryshme të skenarëve të stresit, si skenari afarist, nga ana e aseteve, detyrimeve, të kombinuara dhe vendore. Banka monitoron pozicionin e likuiditetit në një sistem limit gjithëpërfshirës, të përcaktuar si në skenarin afarist të zakonshëm edhe në skenarin e stresit. Sipas apetitit të rrezikut, NLB Banka ka demonstruar një periudhë mbijetese disamujore në skenarin e kombinuar të pafavorshëm, e cila sigurohet nga një bufer me likuiditet të lartë. Nga ana tjetër, në situatën e afarizmit të zakonshëm, pozicionit kumulativ të likuiditetit për një periudhë deri në një vit duhet të jetë pozitiv. Banka ka modele të brendshme për të kontrolluar dhe reduktuar riskun e likuiditetit. Sa i përket portofolios kreditore, ai është i një cilësie të lartë të cilat janë të përqendruara kryesisht në ekspozime afatshkurtra deri në afatmesme, ku nga pikëpamja e riskut të likuiditetit kjo i mundëson bankës të ketë flukse hyrëse të parashikueshme. Nga ana e detyrimeve, të cilat mbeten të jenë burimi ynë kryesor i financimit, prandaj nuk nevojitet përdorimi i instrumenteve të tjera të tregut financiar.

Risku i këmbimit valutor

Risku i këmbimit valutor lind nga ndryshimi i çmimit të një valute kundrejt një valute tjetër. Banka monitoron riskun e këmbimit valutor duke monitoruar këmbimin valutor të pozicioneve të hapura në baza ditore. Ekzistojnë limite të brendshme dhe rregullatore të këmbimit valutor të vendosur sipas valutës dhe në të gjitha valutat. Këto limite monitorohen rregullisht dhe raportohen në takimet e brendshme. Kurset e këmbimit me të cilat operon banka monitorohen nga afër për të kufizuar çdo humbje të mundshme në këmbim valutor, megjithatë, risku i NLB Banka FX është shumë i ulët duke marrë parasysh nivelin e ulët të ekspozimit të pozicioneve të hapura.

Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës
Performanca Financiare
Kanalet moderne të shpërndarjes
Risku i likuiditetit
Biznesi dokumentar
Biznesi dokumentar
Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse
Raporti financiar

NLB Banka vazhdon të jetë banka e vetme në Kosovë që ofron shërbime të këmbimit valutor në treg në nëntë valuta ku përfshihen USD, CHF, GBP, NOK, SEK, AUD, CAD, HRK dhe DKK.


Sistemet e pagesave

Viti 2021 ka qenë i orientuar drejt ofrimit të një eksperiencë unike për klientët për sa i përket qasjes së lehtë të përdoruesit në shërbimet tona elektronike duke përfshirë pagesat. Në fund të vitit 2021 NLB Banka u bë anëtare e SWIFT GPI dhe prezantoi një standard të ri të pagesave ndërkombëtare që lidhet me Iniciativën inovative Globale të Pagesave për të cilën kemi punuar për një kohë të gjatë për të futur standarde të reja për pagesat ndërkombëtare. Duke përdorur shërbimin SWIFT GPI,


klientëve u garantohej pagesa më e shpejtë, me mundësinë që banka të monitorojë transaksionin drejtpërdrejt, në kohë reale dhe të ndjekë nga fillimi deri në përfundimin e transaksionit. Gjithashtu, është e mundur të paraqiten të gjitha kostot që lidhen me pagesën, kohën e saktë të transaksionit, si dhe konfirmimin e kreditimit të fondeve në llogarinë e përfituesit përfundimtar. Një përqindje e lartë e pagesave SWIFT GPI do të kreditohen në llogarinë e përfituesit brenda një harku kohor shumë të shkurtër. Gjithashtu, gjatë vitit 2021 Banka ka bërë zhvillimet e nevojshme në aplikacionin e bankës në mënyrë që të jetë në përputhje me publikimin e standardit SWIFT në lidhje me kategorinë 7 që përfshin afarizmin me biznesin dokumentar. E-banking dhe m-banking ynë miqësor për përdoruesit përfshin një sistem të avancuar sigurie që ofron një qasje të sigurtë, kursim kohe, banking të përshtatshëm online në 24/7, ku klientët tanë mund të

transferojnë fondet në mënyrë elektronike për pagesat kombëtare dhe ndërkombëtare për përfituesit në mbarë botën. . Pagesat ndërkombëtare, krahasuar me vitin 2022 kanë shfaqur trend rritës për pagesat dalëse, ku shuma e pagesave është rritur për 35%, ndërsa në numrin e pagesave është shënuar rritje për 17%. Sa i përket pagesave hyrëse ndërkombëtare është shënuar një rritje në shumën e pagesave për 13%, duke përfshirë në numrin e pagesave hyrëse një rritje për 7%. Për më tepër, vërehet një trend rritës në pagesat ndërkombëtare përmes e/m-banking, nëse krahasojmë të dhënat e vitit 2021 me vitin e kaluar, kemi një rritje të pagesave për 32% në shuma dhe 21% rritje të numrit të pagesave dalëse ndërkombëtare përmes e/m-banking krahasuar me vitin e kaluar.

Ilustrimi 15: Trendi i pagesave ndërkombëtare (hyrëse dhe dalëse)




Ilustrimi 16: Trendi i pagesave dalëse ndërkombëtare përmes e/m-banking




a i përket pagesave vendore krahasuar me vitin 2020, është një trend në rritje për pagesat dalëse në shumën e pagesave për 36%, dhe njëherazi rritje e numrit të pagesave për 28%. Për sa i përket pagesave hyrëse, një rritje e shumës së pagesave për 34%, duke përfshirë edhe numrin e pagesave hyrëse ku kemi një rritje prej 4%.

Ilustrimi 17: Trendi i pagesës vendore (hyrëse dhe dalëse)



Gjithashtu, ka një tendencë në rritje në pagesat e E/Mbanking edhe në pagesat vendore, krahasuar me vitin 2020, për pagesat vendore për 42% në shuma dhe 36% rritje të numrit të pagesave vendore përmes E/M-banking krahasuar me vitin e kaluar.

Ilustrimi 18: Trendi i pagesave dalëse kombëtare nëpërmjet e/m-banking



Biznesi dokumentar

Me përvojën në biznesin dokumentarë, NLB Banka hap perspektiva dhe mundësi të reja për klientët e saj, duke ofruar zgjidhje për t’u mundësuar atyre të tregtojnë jashtë shtetit me besim të plotë dhe të maksimizojnë efikasitetin në zinxhirët e tyre të furnizimit.

NLB Banka në vitin 2021 është shpërblyer për herë të pestë, nga Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim – BERZH si “Banka Emetuese më Aktive në Kosovë për vitin 2020” për përdorimin e PLT (Programit të Lehtësimit të Tregtisë) të BERZH-it.

Në kuadër të Programit të Lehtësimit të Tregtisë, Bankës iu mundësua të mbështesë tregtinë e jashtme për klientët e saj, në, nga dhe midis ekonomive ku BERZH investon përmes një sërë produktesh. Duke qenë pjesë e Grupit NLB i cili ka një prezencë të gjerë dhe ekspertizë profesionale, kjo na ofron një avantazh shtesë në zgjerimin e mbulesës dhe produkteve tona gjeografike.


Në vitin 2021, Banka NLB u bë anëtare e Factor Chain International, e cila do t’i lejojë bankës të promovojë shërbimin e Factoringut dhe të zhvillojë partneritet me organizatat

ndërkombëtare që do t’u mundësojë organizatave vendore dhe ndërkombëtare të bashkëpunojnë në kushte më të sigurta dhe ligjore.

Në vitin 2021 Banka emetoi instrumente financiare tregtare në vlerën totale prej 34 milionë EUR, ku nga kjo shumë rreth 12 milionë EUR ishin garancione dhe rreth 22 milionë EUR letër kredi. Garancionet e pagesave dhe letër kreditë përbëjnë pjesën më të madhe të shumës totale të instrumenteve të biznesit dokumentar të emetuara, të ndjekura nga garancionet e tenderit, garanciont e shërbimit dhe ato doganore.

Në vitin 2021, Banka rriti rolin e saj për t’u ofruar klientëve të saj shërbimin këshillues për përdorimin e duhur të transaksioneve të biznesit dokumentar në mënyrë që të reduktojë riskun e marrëveshjeve tregtare me partnerët ndërkombëtarë përkatës. Banka ka vazhduar gjithashtu të veprojë si agjent në marrëveshjet e lidhura të mirëbesimit dhe lidhur me biznesin dokumentar.

Ilustrimi 19. Garancionet dhe Letër Kreditë



Teknologjia informative

Në vitin 2021, Divizioni për TI ka vazhduar të luaj rolin e tij për të mbështetur aktivitetet afariste dhe për të garantuar efikasitetin e aktiviteteve. Disa projekte infrastrukturore dhe aplikacione janë zbatuar në fushën e TI për të siguruar mbështetjen e duhur të TI për proceset e biznesit dhe iniciativat e zhvillimit që rrisin produktivitetin, performancën, përmirësojnë përvojën e klientit, thjeshtojnë komunikimet dhe përmirësojnë vendimarrjen menaxheriale.

Shumica e projekteve dhe aktiviteteve të infrastrukturës së TI u fokusuan në fushën e sigurisë së TI, produktivitetit dhe vazhdimësisë afariste.

Në procesin e implementimit të Shërbimeve Online të Microsoft-it në të cilat banka është abonuar tre vitet e fundit, banka ka implementuar Azure MFA (autentikimi shumëfaktorësh) për qasje administrative në resurset e brendshme të IT. Qëllimi ishte rritja e sigurisë së qasjes administrative në burimet kritike duke mbrojtur qasjen në të dhëna dhe aplikacionet përmes sigurisë shtesë, duke kërkuar një formë të dytë autentikimi për Administratorët e TI.

Banka ka përfunduar implementimin e zgjidhjes NAC (Network Access Control). HP Aruba ClearPass ishte zgjidhja e zgjedhur nga banka. Zbatimi i zgjidhjes i lejon bankës të kontrollojë pajisjet e biznesit dhe ato personale që lidhen me rrjetin e brendshëm dhe të sigurojë përputhjen me politikën e sigurisë dhe kufizimet e qasjes bazuar në përmbushjen e parametrevë të sigurisë nga pajisja që lidhet.

Një nivel shtesë i mbrojtjes është siguruar për aplikacionet e qasshme nga interneti përmes implementimit të “Web Application Firewall- (WAF)” nga prodhuesi F5. Në këtë mënyrë, ueb aplikacionet e bankës mbrohen nga mashtrimet dhe vjedhjet e të dhënave duke inspektuar dhe filtruar trafikun ndërmjet çdo ueb aplikacioni dhe internetit. Zgjidhja siguron mbrojtje kundër sulmeve të tilla si cross-site-request-forgery (CSRF), cross-site-scripting (XSS), file inclusion, dhe SQL injection.

Një WAF mund të jetë veçanërisht i dobishëm për një kompani që ofron një faqe të e-commerce, shërbime financiare në internet ose çdo lloj tjetër produkti ose shërbimi të bazuar në ueb që përfshin ndërveprime me klientët ose partnerët e biznesit. Në këto raste, ËAF mund të jenë veçanërisht të

dobishëm në parandalimin e mashtrimit dhe vjedhjes së të dhënave. Megjithatë, duke qenë se një ËAF nuk është projektuar për të shmangur të gjitha llojet e sulmeve, ai funksionon më së miri si pjesë e një grupi mjedesh që mbështesin një program gjithëpërfshirës të sigurisë së aplikacionit.

Menaxhimi i dobësive të sigurisë vazhdoi të ishte një pjesë e rëndësishme e strategjisë së sigurisë kibernetike të bankës për zbulimin, hetimin dhe zbutjen e dobësive në rrjetin e ndërmarrjeve përmes softuerëve dhe pajisjeve të ndryshme. Për të mbajtur bankën përpara kërcënimeve, duke kuptuar fillimisht ekspozimin kibernetik dhe më pas duke vendosur masat e duhura zbutëse, burimet e brendshme dhe të jashtme të IT-së së bankave iu nënshtruan testeve të depërtimit të kryera nga kompani të jashtme. Të punësuarit e bankës iu nënshtruan sulmeve të inxhinierisë sociale për të testuar ndërgjegjësimin e tyre të sigurisë.

Banka ka marrë pjesë aktive në nismat rajonale të standardizimit dhe optimizimit në fushat ku janë nisur aktivitete të tilla. Bazuar në strategjinë e standardizimit për pajisjet e rrjetit të qendrave të të dhënave, banka ka marrë pjesë aktive në Procesin e RFP-së dhe ka porositur sasinë e pajisjeve të rrjetit të qendrës së të dhënave që do të zëvendësojë infrastrukturën ekzistuese të rrjetit të qendrës së të dhënave, e cila do të vazhdojë të bazohet në teknologjinë Cisco.

I njëjti proces është ndjekur për zëvendësimin e Tape Library në lokacionin primar dhe sekondar, me të cilat banka do të zbatojë zgjidhjen e re të standardizuar të Grupit NLB, të bazuar në zgjidhjen e IBM Tape Library. Pas një pjesëmarrjeje aktive në procesin e RFP, banka ka porositur pajisjet dhe shërbimet e planifikuara.

Për të shfrytëzuar linjat aktuale të komunikimit me NLB d.d. dhe të zvogëlojë kostot e komunikimit me Qendrën e Përpunimit të Kartelave (Bankart), banka ka migruar lidhjet e komunikimit me Bankart përmes linjave ekzistuese të komunikimit me NLB d.d. Përveç kostove të reduktuara, ky zbatim kontribuoi në një vazhdimësi të zgjeruar të afarizmit, sepse komunikimi me Bankart në rast të dështimit të lidhjes parësore ridrejtohet automatikisht përmes lokacionin sekondar, duke eliminuar kështu nevojën për procedurat manuale të ndërrimit të linjave të komunikimit.

Duke lëvizur drejt përdorimit të plotë të abonimeve ekzistuese të Microsoft 365 dhe veglave të produktivitetit, banka ka kryer me sukses migrimin në një entitet të vetëm (single-tenant) si hapi i parë në zbatimin e Shërbimeve të tjera të Microsoft Cloud. Në fund të vitit 2021, kanë filluar aktivitetet për migrimin në Exchange Online dhe zbatimin e zgjidhjeve të sigurisë si Intune për menaxhimin e pajisjeve mobile, Always on VPN (AoVPN), etj. Në vitin 2021 ka përfunduar procesi i RFP për përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese VOIP. Në fund të vitit 2021, faza e parë e zbatimit përfundoi duke virtualizuar plotësisht infrastrukturën aktuale VOIP. Në tremujorin e parë të 2022, do të pasojë zëvendësimi i plotë i telefonave IP, ku infrastruktura e plotë VOIP do të bazohet në teknologjinë Cisco.

Në vitin 2021 është përgatitur dhe miratuar nga organet përkatëse të bankës strategjia e re e TI-së. Strategjia e TI-së përbën një pjesë integrale të strategjisë së biznesit të Grupit NLB me synimin për të përafruar teknologjinë dhe aktivitetet me qëllimet afariste të përcaktuara në H.O.M.E. strategjinë e bankës. Kjo strategji përcakton qartë qëllimet dhe objektivat për mënyrën se si ato teknologji do të zbatohen dhe përdoren, si dhe artikulon se si strategjia e teknologjisë mbështet objektivat kryesore të afarizmit.

Në mars 2021, Banka ka kryer një testim integral të BCP të shumicës së aplikacioneve të përdoruesve të fundëm me të dhëna nga prodhuesi nën ngarkesa tipike që kanë përfshirë disa njësi organizative.

Në mbështetje të kërkesave të pjesës afariste, IT mori pjesë në përgatitjen, modifikimin dhe testimin e API Backend Connectors dhe Core System-it për të mbështetur kërkesat e projektit LOPA dhe Digital Onboarding me video identifikim. Nga ana tjetër, TI e përmbushi pjesën e saj të detyrave që lidhen me implementimin e anëtarësisë së plotë në SWIFT GPI, konfigurimin dhe mbështetjen për sistemin bazë dhe module të tjera të lidhura dhe raportimin rregullator.

Në vitin 2021, IT implementoi interface të ri me Administratën Tatimore duke përdorur teknologjinë Web API.

Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës
Performanca Financiare
Kanalet moderne të shpërndarjes
Risku i likuiditetit
Biznesi dokumentar
Biznesi dokumentar
Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse
Raporti financiar

Menaxhimi i Riskut

Si një institucion financiar, Banka është në thelb e ekspozuar ndaj llojeve të ndryshme të risqeve si pjesë e aktiviteteve të saj afariste. Kështu, menaxhimi i përgjegjshëm dhe efikas i riskut mundëson një rritje të shëndetshme dhe të qëndrueshme të bankës sonë. Duke pasur një sistem të shëndoshë të menaxhimit të riskut mbështet plotësimin me efikasitet të nevojave të klientëve tanë duke ofruar vlerë për aksionarët dhe palët e interesuara.

Banka ka një qasje gjithëpërfshirëse ndaj menaxhimit të riskut, e cila artikullohet përmes strategjisë sonë të riskut dhe apetitit të riskut. Praktikrat e fuqishme të menaxhimit të riskut integrohen në aktivitetet e përditshme të Bankës, nëpërmjet një strukture organizative të krijuar mirë, të mbështetur dhe të udhëhequr nga një strategji e shëndoshë e menaxhimit të riskut që siguron një pasqyrë dhe llogaridhënie të përshtatshme brenda Bankës. Prandaj, roli kryesor i menaxhimit të riskut është reflektimi dhe zbatimi i apetitit të riskut të NLB Banka sh.a, në mënyrë të integruar dhe konsistente, i cili fillon me të kuptuarit e specifikave të bankës dhe specifikave të tregut, me objektiv të vetëm ruajtjen dhe duke kontribuar në menaxhimin efektiv dhe efikas të riskut.

Një funksion i vendosur mirë i menaxhimit të riskut që përdor një strukturë të drejtorëve joekzekutivë dhe ekzekutivë

mundëson qeverisje të pavarur dhe efikase të riskut. Përdorimi i një modeli të tre linjave të mbrojtjes është shtylla e strukturës së qeverisjes së riskut të Bankës.

Aktivitetet kredituese si një nga aktivitetet kryesore të afarizmit të bankës e ekspozojnë bankën ndaj riskut kreditor, i cili është edhe shtytësi kryesor i ekspozimit ndaj riskut kreditor. Prandaj, për të krijuar një qasje të kujdesshme ndaj menaxhimit të riskut, Banka ka zbatuar praktika të përafruara me strategjinë e menaxhimit të riskut të Grupit NLB dhe rregulloret e BQK-së duke pranuar specifikat lokale dhe dallimet e mjedisit të biznesit që mbizotëron në tregun kosovar. Një qasje e tillë mundësoi instalimin e një sistemi efikas dhe efektiv të menaxhimit të riskut kreditor.

Qeverisja Mjedisore dhe Sociale (ESG) përfaqëson një nga temat kryesore të rëndësishme për Bankën gjatë vitit 2021 dhe është një nga disa fusha të menaxhimit të risqeve. Banka ka krijuar një Sistem të përshtatshëm të Menaxhimit Mjedisor dhe Social (ESMS) i cili na mundëson të kemi një kuptim më të mirë të aktiviteteve të klientëve tanë, duke adresuar çështjet/shqetësimet dhe për të minimizuar/zbutur risqet që lidhen me ESG, si dhe menaxhimin e pritshmërive të palëve tona të interesit.

Risku operacional - Qëllimi i menaxhimit të riskut është të menaxhojë ekspozimin ndaj riskut operacional dhe të zbusë humbjen e mundshme që mund të ndodhë si rezultat

i sistemeve të brendshme të papërshtatshme, procesit të kontrollit, dobësive dhe dështimeve gjatë procesit të punës, aktiviteteve të paligjshme dhe ngjarjeve të jashtme të cilat mund të shkaktojnë humbje për Bankën. Për të mundësuar një sistem të shëndoshë të menaxhimit të riskut operacional, Banka ka krijuar strukturat e duhura (Komiteti i menaxhimit të riskut operacional) dhe ka caktuar përgjegjësinë dhe llogaridhënien përmes një qasjeje të decentralizuar brenda strukturës organizative të Bankës, në mënyrë që të sigurojë identifikimin dhe regjistrimin efikas të riskut , zbutjen dhe monitorimin e riskut operacional. Ngjarjet e humbjeve të shkaktuara nga risku operacional janë ndjekur në baza mujore, janë monitoruar në mënyrë aktive dhe janë raportuar pranë organeve të brendshme të Bankës.

Detajet mbi menaxhimin e riskut duke përfshirë riskun kreditor, riskun e likuiditetit, riskun e normës së interesit, riskun e menaxhimit të kapitalit, etj. janë shpalosur në shënimin (31) në seksionin e menaxhimit të riskut të pasqyrave financiare të audituara.

Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës

Performanca Financiare

Kanalet moderne të shpërndarjes

Risku i likuiditetit

Biznesi dokumentar

Biznesi dokumentar

Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse

Raporti financiar



Ne jemi në ekipin tuaj.

Gjenerata e parë hapi klube.

Gjenerata e dytë fitoi të gjitha kampionatet kombëtare.

Gjenerata e tretë ofroi kampionë rajonal.

Ne do ta ndihmojmë këtë gjeneratë të arrijë yjet.

Asgjë nuk i forcon lidhjet e bashkëpunimit dhe nuk mëson se si të fitosh dhe të humbësh me dinjitet sikur sporti. Sidomos në një rajon me histori sportive kaq të pasur. Meqë besojmë se sporti ka fuqi të madhe për të krijuar lidhje, për të përmirësuar mirëqenien dhe përfshirjen fizike dhe shpirtërore, ne jemi krenarë që mbështesim atletët më të mirë dhe talentët e rinj sportiv në nivel rajonal, ku në mesin e tyre janë vajzat nga ekipi i futbollit U13 NK Radomlje. Në këtë mënyrë, ne po bëhemi një nga sponsorët më të mëdhenj të sportit në rajon.

Përgjegjësia sociale e korporatës

NLB Banka e percepton përgjegjësinë ndaj klientëve, të punësuarve dhe shoqërisë në përgjithësi si një mision. Nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme, Banka ka vazhduar të ndërtojë besueshmërinë e saj, të pasurojë imazhin e saj dhe ta bëjë markën e saj më të fuqishme.

Në vitin 2020, Grupi NLB ka filluar rrugëtimin e integritimit më intensiv të qëndrueshmërisë në operacionet bankare për të përmirësuar dhe zhvilluar rajonin për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm dhe duke qenë anëtare e Grupit i NLB, grupi më i madh bankar dhe financiar në Evropën Juglindore, në krahasim përmbushjes së objektivit të performancës së biznesit, NLB Banka përpaket të përmirësuar cilësinë e jetës edhe përmes projekteve me përgjegjësi shoqërore. Në pjesën më të madhe, aktivitetet tona CSR si donacionet dhe sponsorizimet kryhen në përputhje me qëllimet e OKB-së për zhvillim të qëndrueshëm. Shtyllat kyçe të operacioneve me përgjegjësi shoqërore të NLB Banka janë kujdesi për të punësuarit e saj, pajtueshmëria dhe integriteti, promovimi i sipërmarrjes, mentorimi, mbështetja e sporteve profesionale dhe rinore, aktivitetet humanitare dhe mbrojtja e mjedisit.

Gjatë vitit 2021, Banka ka vazhduar të kontribuojë në mënyrë aktive drejt zhvillimit më të gjerë socio-ekonomik përmes aktiviteteve tona të Përgjegjësisë Sociale të Korporatës në komunitet ku Banka operon me përkushtim të vazhdueshëm ndaj grupeve të ndryshme të shoqërisë, duke mbështetur financiarisht iniciativë që kontribuojnë në shëndet të mirë dhe mirëqenie, cilësi arsimimi, reduktimi i pabarazive, reduktimi i varfërisë, puna e denjë dhe rritja ekonomike dhe kontributi për një mjedis më të gjelbër, plotësisht në përputhje me Parimet e OKB-së për Bankën e Përgjegjshme.

Aktivitetet e ndërmarra për përkrahjen e klientëve/ qytetarëve

Me zhvillimin e shërbimeve bankare digjitale, investimeve dhe sigurimeve, Banka po përpaket të afrohet më shumë me klientët e saj përmes produkteve ankoruese dhe duke ofruar shërbime digjitale të personalizuar që i përshtaten stilit të tyre të jetesës. Banka po kërkon gjithashtu të mbulojë produkte dhe shërbime më komplekse për t'iu përshtatur nevojave të klientëve, dhe të punësuarit në Bankë kanë njohuri më të mira për produktet dhe shërbimet dhe këshillojnë klientët bazuar në ekspertizën dhe përvojën për shërbime që janë të përshtatshme për nevojat e tyre financiare.

NLB Banka ka zbatuar për herë të dytë projektin #Kornizaembështetjes për të mbështetur shtyllat e rëndësishme të ekonomisë, bizneset mikro dhe të vogla që janë prekur më shumë nga COVID-19 në rikuperimin nga pandemia dhe në zhvillimin e biznesit. Përmes "HelpFrame", Banka ka ofruar hapësirën e vet reklamuese për bizneset në promovimin e produkteve të tyre në kanale televizive, portale informative, rrjete sociale, billborde dhe citylight në mbarë Kosovën. Nga ky projekt kanë përfituar 25 biznese vendore nga e gjithë Kosova që janë aktive në prodhim, tregti, shërbime, bujqësi dhe sjellin projekte inovative për mbrojtjen e mjedisit dhe mirëqenies sociale.

Sociale

Gjatë vitit 2021, Banka ka mbështetur aktivitetet sociale dhe humanitare si në vijim:

- OJQ për të verbërit "Shoqata Ndërkomunale e të Verbërve Prishtinë" për të kryer aktivitetet mujore të organizatës.
- Evenimenti "Cycle Kosovo for Children" – një traditë vjetore që mbron politikën e gjelbra dhe mbledhjen e fondeve për një kauzë shumë të rëndësishme, shëndetin e nënave dhe fëmijëve në Kosovë.
- Qendrat e vaksinimit, të gjitha komunitatet e Kosovës - Dhurimi i 90 pajisjeve me nënshkrim digjital së bashku me Shoqatën e Bankave të Kosovës.
- Procesi i vaksinimit dhe personeli shëndetësor –

- donacion për të mbështetur procesin e vaksinimit dhe personelin shëndetësor në Kosovë së bashku me Shoqatën e Bankave të Kosovës.
- Muaji i ndërgjegjësimit të gjirit - NLB Banka ka dhuruar epenteza gjiri, sutjena dhe paruke për gratë e prekura nga kanceri i gjirit.
- Shoqata Kombëtare e Autizmit në Kosovë – përkrahja e talentëve përmes pikturave
- Dhurata të fundvitit për fëmijët me aftësi të kufizuara – dhurata për organizata të ndryshme në mbarë Kosovën.
- OJQ "The Ideas Partnership" – donacion për aktivitete arsimore dhe programe të fëmijëve nga komunitetet e marginalizuara - Romë / Ashkali / Egjiptian
- OJQ "You Can Do " – NLB Banka mbështeti konkursin letrar të organizuar me pjesëmarrës me aftësi të kufizuara nga e gjithë Kosova për të shkruar ese me temë mbi rëndësinë e jetës si person me aftësi të kufizuara, vështirësitë dhe diskriminim nga shoqëria. Esetë do të botohen në një libër.
- AMC – "Aksioni për nënat dhe fëmijët " – donacion për mbështetjen dhe sigurimin e pajisjeve mjekësore për nënat dhe foshnjat premature.
- "Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë" - Donacion në mbështetje të evakuuarve afganë.

NLB Banka ka mbështetur gjithashtu aktivitete që reduktojnë varfërinë dhe urinë duke blerë ushqime esenciale dhe duke ofruar për familjet në nevojë.

Mjedis

NLB Banka kontribuon në aktivitete dhe projekte të ndryshme që ndikojnë në përmirësimin e kushteve në mjedisin ku punojmë dhe jetojmë. Banka është e fokusuar në digjitalizimin e shërbimeve që ndikojnë në uljen e përdorimit të letrës dhe mbrojtjen e mjedisit. Platformat digjitale luajnë një rol të rëndësishëm në kursimin e

Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës

Performanca Financiare

Kanalet moderne të shpërndarjes

Risku i likuiditetit

Biznesi dokumentar

Biznesi dokumentar

Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse

Raporti financiar

letrës që shpenzohet gjatë ofrimit të shërbimeve për klientët në Filialat e Bankës, dhe pajisja e klientëve me shërbime elektronike si e-banking dhe m-banking reduktin përdorimin e letrës, duke kursyer kështu prerjen e drunjëve. Në kuadër të nismës "Të duam dhe të mbrojmë natyrën", Banka ka përfunduar aktivitetin e mbjelljes së 123 drunjëve në Parkun Memorial Velania. Ne e kemi ulur gjurmën tonë të karbonit në mënyrë indirekte, nëpërmjet aktiviteteve tona të kreditimit dhe investimit: duke u përmbajtur nga bizneset e lidhura me qymyrin dhe financimi i projekteve që lidhen me ekonominë me karbon të ulët.

Kultura

NLB Banka është e përkushtuar në mbështetjen e aktiviteteve kulturore. Në vitin 2021, Banka ka sponsorizuar filmin

dokumentar kushtuar jetës dhe veprës së akademikut Gazmend Zajmi dhe kontributit të tij për zhvillimin e Universitetit të Prishtinës gjatë periudhës kur ai ishte në krye të këtij institucioni më të lartë të dijes në Kosovë. Më tej, Banka ka mbështetur filmin dokumentar “Arkitekti i Universitetit të Pavarur të Prishtinës dhe roli i Prof.Dr. Ejup Statovci”.

Sporti

Në fushën e sportit, NLB Banka edhe gjatë vitit 2021 ka mbetur ndër mbështetësit kryesorë të të gjitha sporteve, duke mbështetur në mënyrë të vazhdueshme:

- Klubin e futbollit “FC Prishtina” si sponsor tradicional.
- Sponsorimin e Hana Beiqi, notuese në klubin sportiv “H2O”.

- Klubin e basketbollit “KB Bashkimi”, si sponsor tradicional.
- Klubi i shahut “KSH Prishtina” – NLB Banka ka sponsoruar aktivitetet e klubit për pjesëmarrje në Gara e Federatës së Shahut.
- Klubin e Hendbollit “KH Vllaznimi” – NLB Banka ka sponsoruar pjesëmarrjen e klubit në Garat Evropiane.
- Klubin e shahut “KSH Drejtësia” – sponsorimi i turneut përkujtimor të shahut kushtuar ish-të punësuarit të Bankës “Mustafë Ibrahimit”.

,

Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës

Performanca Financiare

Kanalet moderne të shpërndarjes

Risku i likuiditetit

Biznesi dokumentar

Biznesi dokumentar

Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse

Raporti financiar

A woman with brown hair tied back, wearing a blue and white striped shirt and a black backpack, is leaning on a wooden fence and looking towards the right. Two young boys are standing next to her, also looking in the same direction. They are in a grassy field with mountains in the background under a blue sky with white clouds. A thin purple arc is visible on the right side of the image.

Ne jemi të vëmendshëm për gjërat që ju vlerësoni më shumë.

52 vjet më parë, ne festuam Ditën e Tokës për herë të parë.
40 vjet më parë, ne prezantuam riciklimin.
2 vjet më parë, ne u angazhuam për ekonomi me karbon të ulët.
Për çfarë do të angazhohen gjeneratat e ardhshme?

Rritja e rëndësisë së çështjeve mjedisore dhe sociale luan një rol të rëndësishëm në cilësinë e jetës në rajonin tonë. Duke përfshirë qëndrueshmërinë në shërbimet tona bankare, ne jo vetëm që forcojmë marrëdhëniet me klientët, punonjësit, furnizuesit, investitorët dhe komunitetet më të gjëra, por gjithashtu kujdesemi për gjeneratat e tashme dhe të ardhme. Ne nuk e perceptojmë qëndrueshmërinë thjesht si një shkronjë në një copë letër, por si një varg vendimesh, masash dhe veprimesh që do të ofrojnë mundësi të reja për gjeneratat në vazhdim.

Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Ne jemi të përkushtuar ndaj kulturës së përgjegjësisë, respektimit të legjislacionit dhe rregullave, parimeve të përsosmërisë dhe integritetit dhe promovimit të organizimit mbështetës në Grupin NLB.

Besimi që kemi te klientët, bashkëpunëtorët, aksionarët dhe shoqëria në përgjithësi na jep përgjegjësi të madhe. Ne e justifikojmë këtë besim duke punuar me palët kryesore të interesit për ndryshime pozitive, përfitime reciproke dhe rritje.



Së bashku me të punësuarit kaluam dhe u përballëm me sfida të ndryshme përgjatë vitit 2021 dhe përballja jonë me të në mënyrë të natyrshme, si në fusha të tjera, u rëndua nga situata me pandeminë Covid-19.

Përballja jonë me pandeminë Covid-19 e cila krijoi frikë dhe panik, sepse gjurmët e saj të përhapura kudo rreth nesh vazhduan edhe në vitin 2021. Prandaj, grupi i Krizës vazhdoi punën e tij dhe u siguroi që të merrte vendimet e duhura për veprime të shpejta për të mbrojtur të punësuarit, klientët dhe qytetarët.

Si pasojë e kësaj pandemie, edhe sot jetojmë me sjellje të reja, me kërkesa të reja. Ne jetojmë me realitetin e ri imponues, të dhimbshëm dhe të kushtueshëm.

Megjithatë, përkundër këtij realiteti jo lehtësisht të përballueshëm, ne arritëm të jemi pranë të punësuarve tanë dhe nëpërmjet tyre edhe klientëve tanë, kemi qenë pranë tyre dhe për ta gjatë gjithë vitit. Si gjithmonë, ne ishim në shërbim të tyre, duke iu përgjigjur në kohë kërkesave të tyre.

Ilustrimi 20. Struktura e të punësuarve



Ishte një tjetër përballje e suksesshme, megjithëse me një brishtësi të përgjithshme! Suksesi që nuk i përket askujt individualisht, por të gjithëve së bashku dhe të gjithëve neve. Puna, angazhimi dhe kontributi i secilit individ dhe i të gjithëve së bashku janë themeli i suksesit të Bankës sonë.

Krahas aktiviteteve me të cilat merret në baza ditore Shërbimi për Burime Njerëzore dhe Organizim, gjatë vitit 2021 janë realizuar edhe këto aktivitete kryesore:

- Hulumtimi i angazhimit të Punësuarve, me kompaninë e jashtme "Interpretacija" nga Sllovenia
- Organizimi i hulumtimit të Kulturës Organizative në nivelin e Grupit NLB me kompaninë e jashtme "Human Synergetic";
- Organizimi i Leadership/Impact dhe Management/Impact për B-1 dhe Menaxhmentin me kompaninë e jashtme "Human Synergetics".
- Shpallja e vendeve të lira të punës, testimi i kandidatëve, intervistat dhe përfundimi i procesit të punësimit si dhe Përpilimi i kontratave, vendimeve të ndryshme.
- Nënshkrimi i kontratës me kompaninë private të sigurimeve shëndetësore Scardian për procesin e sigurimit shëndetësor të gjithë punësuarve të Bankës, i cili bëhet çdo vit.
- Nënshkrimi i kontratës me laboratorin privat Avicena për kryerjen e testimit COVID-19 për të punësuarit e Bankës sipas nevojës.

- Organizimi i trajnimeve të ndryshme online dhe të brendshme dhe të jashtme me trajnerë të njohur ndërkombëtarisht.
- Organizimi i vlerësimit të performancës dhe shpërndarjes së bonusit.
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme me grupin e Talentëve, si trajnimet e aftësive të buta, mentorimi, trajnimi në hije (shadowing), coaching, projekte të ndryshme, klubi i librit, fokus grupet etj.
- Aktivitetet lidhur me Employee Brand që është aktivitet në kuadër të Grupit NLB.
- Themelimi i klubit të Librit me më shumë se 30 bestseller ndërkombëtar në vitin e parë.

Tabelë 6. Trajnimet e të punësuarve

Trajnime të jashtme	2021
Nr. i trajnimeve të jashtme	122
Nr. i pjesëmarrjeve	641

Trajnime të brendshme	2021
Nr. i pjesëmarrjeve në trajnime të brendshme	1,009
Nr. i pjesëmarrjeve në trajnime online	138
Nr. i trajnimeve në modulin ECHO	7
Nr. i pjesëmarrjeve në trajnime në modulin ECHO	3,154
Mesatarja e orëve të trajnimit për punonjës	20

Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës

Performanca Financiare

Kanalet moderne të shpërndarjes

Risku i likuiditetit

Biznesi dokumentar

Biznesi dokumentar

Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse

Raporti financiar

Përmbajtja


Qeverisja Korporative

Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse

Banka ka një strukturë të qartë organizative që saktësisht përcakton të drejtat dhe përgjegjësitë e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve dhe Organeve të tjera udhëheqëse, të punësuarit e tjerë, si dhe të linjave të kontrollit në kryerjen e detyrave të përditshme.

Struktura organizative e NLB Banka është si në vijim:
The organizational structure of NLB Banka is as follows:

- Organet kryesore të Bankës janë:
- Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve,
 - Bordi i Drejtorëve
 - Komiteti i Auditimit
 - Komiteti i Menaxhimit të Riskut
 - Bordi Udhëheqës i Bankës



Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës

Performanca Financiare

Kanalet moderne të shpërndarjes

Risku i likuiditetit

Biznesi dokumentar

Biznesi dokumentar

Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse

Raporti financiar

Mbledhja e përgjithshme e Aksionarëve

Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve të Bankës organizohet dhe merr vendime në takimet e rregullta dhe të jashtëzakonshme, ku merr vendime në përputhje me ligjin. Aksionet nominale i përcaktojnë pronarëve të drejtën mbi pagesën e dividendës dhe të drejtën e votës në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve. Përgjegjësitë e Mbledhjes së Përgjithshme të Aksionarëve të Bankës janë të përcaktuara me Statutin e NLB Banka, të cilat janë gjithashtu në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga rregullatori. Gjatë vitit 2021, Mbledhja e Përgjithshme e Aksionarëve ka mbajtur tri mbledhje, një mbledhje të rregullt dhe dy të jashtëzakonshme. Në mbledhjen e rregullt të mbajtur më 26 mars 2021 janë miratuar disa akte, ndër të cilat: Raporti i Auditorëve të Jashtëm për vitin 2020, Plani Afarist për periudhën 2021-2025, emërimi i Auditorit të Jashtëm për vitin 2021 dhe plotësimet dhe ndryshimet e Statutit të NLB Banka, ndërsa në mbledhjet e jashtëzakonshme janë miratuar përbërja e re e Bordit të Drejtorëve dhe ndryshimet e Statutit/ndryshimet në strukturën aksionare të NLB Banka sh.a. Prishtina dhe në mbledhjen e jashtëzakonshme të mbajtur në dhjetor 2021 është aprovuar shpërndarja e dividendës së fitimit neto nga viti 2019 dhe 2020 në vlerë prej 23.6 milionë EUR.

Përbërja e Bordit të Drejtorëve

Bordi i Drejtorëve zgjidhet nga aksionarët e Bankës, në Mbledhjen e Përgjithshme të Aksionarëve dhe është përgjegjës pos tjerash edhe për krijimin e politikave, duke përfshirë Politikat për menaxhimin e riskut dhe mbikëqyrjen e zbatimit të tyre. Bordi i Drejtorëve kryen detyrat në përputhje me dispozitat e ligjit mbi bankat dhe Statutin e Bankës. Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2021 ka mbajtur 8 mbledhje: 5 mbledhje të rregullta dhe 3 të jashtëzakonshme. Struktura e anëtarëve të Bordit të Drejtorëve të NLB Banka sh.a. Prishtinë më 31 dhjetor, 2021, ishte si në vijim:

- Z. Blaž Brodnjak, kryesues
- Z. Peter Zelen, zëvendës kryesues
- Znj. Mateja Treven, anëtar

- Z. Abdylmenaf Bexheti, anëtar
- Znj. Ardiana Bunjaku, anëtar
- Z. Albert Lumezi, anëtar – Kryetar i Bordit Udhëheqës të NLB Banka sipas funksionit pa të drejtë vote.

Komiteti i Auditimit

Anëtarët e Komitetit të Auditimit me datë 31 Dhjetor 2021 ishin si në vijim:

- Znj. Mateja Treven, Kryetar i Komitetit të Auditimit
- Z. Peter Zelen, anëtar i Komitetit të Auditimit
- Z. Goce Hristov, anëtare e Komitetit të Auditimit

Komiteti i Auditimit është themeluar në bazë të Ligjit për bankat ndërsa puna dhe aktivitetet e saja janë përcaktuar në Rregulloren e Punës së Komitetit të Auditimit. Komiteti i Auditimit mban së paku një mbledhje në çdo tre muaj. Gjatë vitit 2021 janë mbajtur gjithsej katër (4) mbledhje. Fushat e mbuluara nga Komiteti i Auditimit janë: miratimi i raporteve të auditimit të brendshëm, vlerësimi i procedurave të auditimit, vlerësimi i kontroleve të brendshme, rishikimi i raportit të pajtueshmërisë, rishikimi i performancës financiare të bankës, rishikimi i letër rekomandimit të auditorëve të jashtëm dhe pasqyrat financiare të audituara. Përveç kësaj, komiteti i auditimit gjithashtu bën njohjen, vlerësimin dhe miratimin e rekomandimeve dhe nxjerr vendime lidhur me dokumentet e rregullatorit të jashtëm.

Komiteti i Riskut

Më datë 31 dhjetor 2021, anëtarët e Komitetit të Riskut ishin si në vijim:

- Z. Peter Zelen, kryesues
- Znj. Ardiana Bunjaku, anëtare
- Z. Abdylmenaf Bexheti, anëtar

Komiteti i Menaxhimit të Riskut është themeluar në bazë të Ligjit për bankat dhe funksionon në bazë të Rregullores së brendshme të Komitetit për Menaxhimin e Rrezikut. Komiteti i menaxhimit të rrezikut ndihmon Bordin e Drejtorëve me fokus të specializuar në fushën e menaxhimit të riskut. Në Komitet janë anëtarë tre drejtorë jo-ekzekutiv.

Komiteti i menaxhimit të riskut mban së paku një mbledhje në çdo tre muaj në mënyrë që të monitorojë ekspozimin ndaj riskut dhe menaxhimin e riskut të Bankës. Gjatë vitit 2021 janë mbajtur gjithsej katër (4) mbledhje. Komiteti si i tillë mbikëqyr fushën e riskut kreditor, riskut të tregut dhe riskun operacional, me qëllim të zbatimit efikas dhe efektiv të apetitit të administrimit të riskut dhe strategjisë së riskut të NLB Banka.

Përbërja e Bordit Udhëheqës të Bankës

Bordi Udhëheqës i Bankës, udhëheq, përfaqëson dhe vepron në emër të Bankës, në mënyrë të pavarur dhe me vetë-përgjegjësi, ashtu siç parashihet me Statutin e Bankës. Kryetari dhe anëtarët emërohen me mandat katër vjeçar me mundësi të rizgjedhjes, në përputhje me kushtet e përcaktuar me Ligji dhe Statutin e Bankës. Bordi Udhëheqës i NLB Banka përbëhet nga tre persona:

- z. Albert Lumezi, Kryetar i Bordit Udhëheqës
- z. Lavdim Koshutova, anëtar i Bordit Udhëheqës
- z. Gem Maloku, anëtar i Bordit Udhëheqës

Me qëllim të sigurimit të funksionimit të duhur të afarizmit të Bankës si dhe monitorimin e aktiviteteve të rregullta, brenda Bankës gjithashtu veprojnë këto Komitete operationale:

- Komitetit për menaxhimin e Aktivës dhe Pasivës (ALCO - brenda komitetit ALCO është themeluar nën-komiteti i quajtur Komiteti i çmimeve)
- Komiteti kreditor
- Komiteti për Menaxhimin e Riskut Kreditor
- Komiteti i sigurisë
- Komiteti për Menaxhimin e Riskut Operacional
- Komiteti i TI-së
- Komiteti për Punë të Personelit
- Komiteti i Prokurimit
- Komiteti i Marketingut.
- Komiteti i parandalimit të shpëlarjes së parave
- Komiteti për menaxhimin e të dhënave

Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës
Performanca Financiare
Kanalet moderne të shpërndarjes
Risku i likuiditetit
Biznesi dokumentar
Biznesi dokumentar
Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse
Raporti financiar

Auditimi i Brendshëm

Funksioni i auditimit të brendshëm në NLB Banka kryhet nga Sektori i Auditimit të Brendshëm. Sektori i Auditimit të Brendshëm është funksion i pavarur në bankë që në aspektin funksional i raporton direkt Komitetit të Auditimit të Bordit të Drejtorëve të Bankës, ndërsa në mënyrë administrative i raporton një anëtar i Bordit Udhëheqës të Bankës. Objektivi kryesor i Sektorit të Auditimit të Brendshëm është të ofrojë siguri objektive dhe këshilluese me qëllim të shtimit të vlerës dhe përmirësimit të proceseve në Bankë. Kjo arrihet duke përdorur një qasje sistematike dhe profesionale për të vlerësuar dhe përmirësuar menaxhimin e riskut, sistemin e kontrollit të brendshëm, qeverisjen dhe efikasitetin e operacioneve të bankës. Auditimi i brendshëm jep një kontribut të rëndësishëm për Bankën për të përmbushur objektivat e saj strategjike dhe afariste dhe për të aplikuar praktikat më të mira bankare. Metodologjia e punës së Auditimit të Brendshëm, kompetencat dhe përgjegjësitë janë të përcaktuara në rregulloren për Auditimin e Brendshëm në NLB Banka Prishtinë dhe Metodologjinë e Auditimit të Brendshëm, të cilat janë plotësisht në përputhje me standardet e Auditimit të Brendshëm në NLB d.d, praktikat më të mira ndërkombëtare të auditimit, si dhe ligjet dhe rregulloret e Kosovës lidhur me auditimin.

Auditimi i brendshëm funksionon dhe është në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Praktikës Profesionale të Auditimit të Brendshëm dhe me Kodin e Etikës së auditimit të brendshëm dhe Rregullat dhe Rregulloret e Kosovës. Sektori i Auditimit të Brendshëm përbëhet nga katër punonjës. Aktivitetet e auditimit të brendshëm kryhen në përputhje me Planin e Auditimit të Brendshëm, i cili përgatitet në baza vjetore duke përdorur një qasje të bazuar në risk në përputhje me qëllimet dhe objektivat e Bankës. Qasja e bazuar në risk përdoret gjithashtu në përcaktimin e fushës së auditimit të secilit angazhim të planit të auditimit, përfshirë kohën dhe shpërndarjen e burimeve. Secili Plan i Auditimit të Brendshëm miratohet nga Komiteti i Auditimit i Bankës. Plani i Auditimit të Brendshëm azhurnohet rregullisht për të pasqyruar ndryshimet përkatëse që adresojnë rreziqet kryesore të bankës në një moment të caktuar kohor. Gjatë vitit 2021, Sektori i Auditimit të Brendshëm ka kryer 22 auditime sipas planit të auditimit për vitin 2021. Raportet e auditimit të brendshëm kryesisht përbëhen nga opinioni i auditorëve të brendshëm, gjetjet, shkaqet, risqet dhe rekomandimet si dhe veprimet e dakorduara për t’u ndërmarrë nga procesi për zbatimin e rekomandimeve të dhëna. Raportet

miratohen nga Komitetin e Auditimit të Bankës në baza tremujore. Rekomandimet e dhëna në raportet e auditimit ndiqen rregullisht dhe i raportohen Bordit Udhëheqës si dhe Komitetit të Auditimit të Bankës. Më pas, Bordi i Drejtorëve të Bankës gjithashtu informohet për vëzhgimet kryesore në baza tremujore. Auditimi i Brendshëm vazhdimisht bashkëpunon me Auditimin e Brendshëm të NLB d.d. në lidhje me auditimet e përbashkëta, auditimet e kryera në nivel grupi si dhe metodologjinë e punës së auditimit. Përveç kësaj, raportimi tremujor paraqitet në Auditimin e Brendshëm të NLB d.d. në lidhje me vëzhgimet kryesore, rekomandimet e vonuara si dhe rekomandimet kyçe të dhëna nga rregullatorët. Më në fund, Auditimi i Brendshëm ofron raporte të auditimit të brendshëm për auditorët e jashtëm dhe palët e jashtme (policia, kompanitë e sigurimeve dhe rregullatori) sipas kërkesës së tyre. Së fundi, në vitin 2021 cilësia e punës së Sektorit të Auditimit të Brendshëm vlerësohet një herë në vit nga NLB d.d, dhe në baza pesëvjeçare nga vlerësuesi i jashtëm i pavarur.

- Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës
- Performanca Financiare
- Kanalet moderne të shpërndarjes
- Risku i likuiditetit
- Biznesi dokumentar
- Biznesi dokumentar
- Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse
- Raporti financiar

Sektori për Pajtueshmëri dhe Integritet

Pajtueshmëria dhe Integriteti është sektor i pavarur në Bankë që informon dhe këshillon menaxhmentin e lartë dhe raporton pranë Bordit të Drejtorëve (përmes Komitetit të Auditimit). Korniza ligjore dhe integriteti i sektorit të pajtueshmërisë është krijuar në përputhje me kërkesat e Standardeve minimale të Pajtueshmërisë dhe Integritetit të Grupit NLB, dhe Rregullores për Qeverisjen Korporative të Bankave (rregullorja lokale). Sektori përbëhet nga tre të punësuar – Udhëheqësi i Sektorit dhe dy zyrtar të lartë.

Në përgjithësi, aktivitetet e realizuara të pajtueshmërisë dhe integritetit mbulojnë zbatimin e detyrave sipas planit vjetor të punës 2021, zbatimin e rekomandimeve të nxjerra nga Linja e Pajtueshmërisë NLB dd, zbatimin e rekomandimeve të Vlerësimit të Riskut të Kompanisë, rishikimin e rregullt dhe azhurnimin e akteve të brendshme të Sektorit të Pajtueshmërisë dhe Integritetit në lidhje me zbatimin e Standardeve (Standardet e Pajtueshmërisë dhe Integritetit në Grupin NLB) kryerjen e rishikimit të rregullt dhe të jashtëzakonshëm të përputhshmërisë në proceset bankare dhe monitorimin e zbatimit të masave të nxjerra.

Sektori i Pajtueshmërisë dhe Integritetit bashkëpunon ngushtë me Linjën e Kompetencës së Pajtueshmërisë në NLB dd, në lidhje me zbatimin e Standardeve të Pajtueshmërisë dhe Integritetit të Grupit NLB, në lidhje me metodologjinë e punës në çështjet e pajtueshmërisë, përgatitjen e Raportit të Pajtueshmërisë në baza tremujore etj.

Aktivitetet tjera me rëndësi të zhvilluara nga Sektori për Pajtueshmëri dhe Integritet gjate vitit 2021 janë:

- Vlerësimi i riskut të pajtueshmërisë së ndërmarrjes (ECRA) – përditësim për vitin 2021, bazuar në Udhëzimet për Zbatimin e Vlerësimit të Riskut të Pajtueshmërisë së Ndërmarrjeve (Gusht 2019).
- Rishikimet e pajtueshmërisë në katër fusha dhe procese - prokurimi i produkteve dhe shërbimeve; sistemi lokal i menaxhimit të informacionit të brendshëm; rishikimi i kontrollit të brendshëm dytësor në degët e Bankës; rishikimi i proceseve të kredive të retail në lidhje me risqet rregullatore, konfliktin e interesit dhe korrupsionin, si dhe risqet që lidhen me etikën dhe integritetin.
- Anketa e shkurtër (kuize me shpërblime), me qëllim të vendosjes së këndvështrimit (perceptimit) të punësuarve mbi situatën në Bankë në lidhje me menaxhimin e konfliktit të interesit dhe kundër ryshfetit dhe korrupsionit, menaxhimin e dhënies/pranimit të dhuratave.
- Identifikimi dhe monitorimi i ndryshimeve ligjore/ rregullative me efekt në operacionet e bankës; informacione të punësuarve të bankës lidhur me ndryshimet ligjore/rregullatore (e-buletin periodik) dhe aktivitete të tjera ndërgjegjësuere mbi pajtueshmërinë dhe integritetin.
- Rishikimi i akteve të brendshme të sektorit të Pajtueshmërisë dhe Integritetit – përditësimi

- në përputhje me kërkesat e Standardeve të Pajtueshmërisë dhe Integritetit në Grupin NLB.
- E-learning vjetor i rregullt dhe aktivitete të tjera edukimi dhe ndërgjegjësimi mbi temat e Pajtueshmërisë dhe Integritetit - Etika, Integriteti dhe Kodi i Sjelljes, Parandalimi i konfliktit të interesit dhe korrupsionit, dhuratat, Parandalimi i sjelljes së keqe dhe sjelljeve të dëmshme, Parandalimi i abuzimit në tregun e instrumenteve financiare .
 - Mbështetja e NjO duke dhënë mendime, këshilla dhe propozime në zgjidhjen e çështjeve të ndryshme bankare.
 - Hetimi i rasteve të dyshuara për sjellje të dëmshme.
 - Aktivitetet e marrëdhënieve me investitorët bazuar në Rregullat për Informacionin e Brendshëm - komunikimi me të punësuarit në lidhje me periudhën e mbyllur (periudhë gjatë së cilës personave të caktuar të identifikuar u ndalohej të angazhohen në transaksione që përfshijnë aksione dhe instrumente të tjera financiare të NLB d.d., Ljubljana).
 - Raporti FATCA për vitin 2021 (më 31.12.2021) me informacion sipas kërkesave të marrëveshjes FATCA dhe dorëzimin e tij në Administratën Tatimore të Kosovës.

Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës

Performanca Financiare

Kanalet moderne të shpërndarjes

Risku i likuiditetit

Biznesi dokumentar

Biznesi dokumentar

Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse

Raporti financiar

Sektori për parandalimin e shpërlarjes së parave dhe Financimin e Terrorizmit (PSHP/FT)

Banka është plotësisht në dijeni të kërkesave të PSHP/FT si në nivel lokal dhe ndërkombëtar dhe kupton rreziqet e SHP / FT. Në këtë drejtim, banka implementon politikën e tolerancës zero ndaj përdorimit të produkteve dhe shërbimeve tona bankare për qëllime të paligjshme. Sektori për PSHP/FT ka vazhduar me adaptimin e vazhdueshëm të politikave dhe procedurave në përputhje me kërkesat e reja ligjore për PSHP/FT dhe standardet e Grupit NLB, gjatë viti 2021 fokusi ka qenë në Customer Risk Rating Project (Siron KYC) dhe Shqyrtimi i KYC për klientët. Në koordinim dhe me mbështetjen e AML të Grupit, aktivitetet kryesore janë si në vijim:

- Vlerësimi sasior dhe cilësor i riskut I PSHP/FT - Metodologjia e grupit.
- Fillimi i Plan Projektit “Customer Risk Rating” (Siron KYC).

- Aprovimi i Politikës mbi pranimin e bërjes së afarizmit me klientë me rrezik të lartë dhe apetitin e riskut në lidhje me MLTF në NLB Banka sh.a.
- Shqyrtimi i KYC për klientët me risk të lartë.
- Implementimi i metodologjisë e-learning të Grupit.
- Aprovimi i Politikës së Parandalimit të Shpërlarjes së parave dhe Parandalimit të financimit të terrorizmit, versioni 4.
- Aprovimi i Rregullores së Komitetit të AML.
- Rekrutimi i të punësuarit të ri të Sektorit për AML.
- Përgatitja dhe lëshimi i udhëzimeve dhe memove të shumta për stafin e shitjes.

Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës

Performanca Financiare

Kanalet moderne të shpërndarjes

Risku i likuiditetit

Biznesi dokumentar

Biznesi dokumentar

Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse

Raporti financiar

Ngjarjet pas bilancit te gjendjes

Më 25 shkurt 2022, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë vendim për vendosjen e sanksioneve ndaj Rusisë në përputhje me sanksionet e SHBA-së dhe BE-së. Banka po trajton me kujdes dhe me ndërgjegjësim të lartë transaksionet e mundshme me vendet e përfshira në konflikt. Banka nuk ka asnjë ekspozim ndaj këtyre vendeve, dhe nuk pritet ndonjë ndikim i mundshëm i lidhur me performancën e bankës.

Sipas informacioneve të publikuara, tregtia ndërmjet Kosovës dhe Ukrainës është e ultë, rreth 30 milionë në një vit, ndërsa me Rusinë mund të konsiderohet që nuk ka tregti.

Industritë që pritet të ndikohen janë: industria e hekurit, e drurit dhe e drithërave. Së fundmi është Vërejtur edhe ndikimi në rritjen e çmimeve të industrisë së naftës. Ekspozimi i vlerësuar i bankës në këto industri, përfshirë industrinë e naftës është më e ultë se 6.7% e portofolit të bankës.

Nuk ka ndodhur asnjë ngjarje tjetër materiale pas datës së pasqyrës së pozitës financiare, që kërkojnë dhënie informacionesh shpjeguese në pasqyrat financiare.

Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës

Performanca Financiare

Kanalet moderne të shpërndarjes

Risku i likuiditetit

Biznesi dokumentar

Biznesi dokumentar

Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse

Raporti financiar

Raporti financiar

- Deklarata e Kryetarit të Bordit Udhëheqës
- Performanca Financiare
- Kanalet moderne të shpërndarjes
- Risku i likuiditetit
- Biznesi dokumentar
- Biznesi dokumentar
- Qeverisja Korporative dhe Organet Udhëheqëse
- Raporti financiar

NLB BANKA SH.A.

PASQYRAT FINANCIARE TË PËRGATITURA NË PËRPUTHJE ME
STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR

PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2021

ME RAPORTIN E AUDITORIT TË PAVARUR

PËRMBAJTJA	FAQE
DEKLARATA MBI PËRGJEGJËSITË E MENAXHMENTIT	3
RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR	4
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE	6
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE	7
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET	8
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	9
SHËNIMET PËR PASQYRAT FINANCIARE	10 - 81

DEKLARATA MBI PËRGJEGJËSITË E MENAXHMENTIT

Për aksionarët dhe bordin e drejtorëve të NLB Banka sh.a.

Bordi Udhëheqës konfirmon përgjegjësinë e tij për përgatitjen e pasqyrave financiare të Bankës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021, dhe për politikat që shoqërojnë kontabilitetin dhe shënimet e pasqyrave financiare.

Bordi Udhëheqës është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për të dhënë një pamje të vërtetë dhe të drejtë të pozitës financiare të Bankës më 31 dhjetor 2021, rezultatet financiare dhe rrjedhën e parasë për vitin e përfunduar.

Bordi Udhëheqës gjithashtu konfirmon se politikat e duhura kontabël janë aplikuar në mënyrë konsistente dhe se vlerësimet e kontabilitetit janë përgatitur në përputhje me parimet e kujdesit dhe menaxhimit të mirë. Bordi udhëheqës më tej konfirmon se pasqyrat financiare të Bankës, së bashku me shënimet shpjeguese, janë përgatitur në përputhje me parimin e vazhdueshmërisë së operimit të biznesit dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Bordi Udhëheqës është gjithashtu përgjegjës për praktikën e përshtatshme kontabël, për miratimin e masave të përshtatshme për ruajtjen e pasurive, dhe për parandalimin dhe identifikimin e mashtrimit dhe parregullsive të tjera ose aktiviteteve të paligjshme.

Prishtinë, Kosovë
28 shkurt 2022

Bordi Udhëheqës




Lavdim Koshutova

Anëtar i Bordit Udhëheqës



Gem Maloku

Anëtar i Bordit Udhëheqës



Albert Lumezi

Kryetar i Bordit Udhëheqës



**Building a better
working world**

Ernst & Young Certified Auditors
Ltd - Kosovo
Rr. Bajram Kelmendi 92 3rd floor
Prishtine, Kosove

Tel: +383 38 220 155
Fax: +383 38 220 155
ey.com

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Aksionerët e NLB Banka Sh.a

Opinionit

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të NLB Banka Sh.a (më poshtë "Banka"), që përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2021, dhe pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse, pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin drejtë, në të gjitha aspektet materiale pozicionin financiar të Bankës më 31 dhjetor 2021, dhe të rezultatit të saj financiar dhe rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF").

Baza për opinionin

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ("SNA-të"). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në paragrafin Përgjegjësia e Auditorit për auditimin e pasqyrave financiare të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Banka në pajtim me Kodin e Etikës për Profesionistët Kontabël të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Profesionistët Kontabël (duke përfshirë Standardet Ndërkombëtare të Pavarsisë) ("Kodi BSNEPK") së bashku me kërkesat etike që janë të përshtatshme për auditimin e pasqyrave financiare në Kosovë, dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me këto kërkesa dhe me Kodin BSNEPK. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Informacione të tjera të përfshira në Raportin Vjetor të vitit 2021 të NLB Banka Sh.a.

Informacione të tjera përfshijnë informacione në Raportin Vjetor të Bankës për vitin 2021, përveç pasqyrave financiare dhe këtij raporti të auditorit. Menaxhmenti është përgjegjës për informacionet e tjera. Raporti Vjetor i Bankës për vitin 2021 pritet të na vihet në dispozicion pas datës së këtij raporti të auditorit.

Opinionit ynë mbi pasqyrat financiare nuk mbulon informacionet e tjera dhe ne nuk shprehim ndonjë lloj konkluzioni që jep siguri në lidhje me këto informacione.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, ne kemi përgjegjësinë të lexojmë informacionet e tjera të identifikuar më lartë kur ato të na vihen në dispozicion dhe të vlerësojmë nëse këto informacione kanë inkoherenca materiale me pasqyrat financiare apo me njohjen që ne kemi marrë gjatë auditimit ose përndryshe, nëse duket se ato janë me anomali materiale.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrole të brendshme, që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësitë e menaxhmentit dhe të personave të ngarkuar me qeverisjen për pasqyrat financiare (vijon)

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Bankës për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur menaxhmenti synon ta likujdojë Bankën ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër. Personat që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Bankës.

Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e pasqyrave financiare

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë.

Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me SNA- të do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston. Anomali mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arsyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:


- ▶ Identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalisë materiale të pasqyrave financiare, qoftë për shkak të mashtrimit ose gabimit, hartojmë dhe kryejmë procedurat e auditimit në përgjigje të këtyre rreziqeve, dhe marrim evidenca auditimi që janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar një bazë për opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale si rezultat i mashtrimit është më i lartë se rreziku si rezultat i gabimit, sepse mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, përjashtime të qëllimshme, informacione të deformuara, anashkalime të kontroleve të brendshme.
- ▶ Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm, që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të Bankës.
- ▶ Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- ▶ Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijimësisë, bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e Bankës për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit në lidhje me shpjegimet e dhëna në pasqyrat financiare, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që Banka të ndërpresë veprimtarinë.
- ▶ Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me ata që janë të ngarkuar me qeverisjen e NLB Banka Sh.a, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

Ernst & Young Certified Auditors Kosovo sh.p.k.


7 mars 2022
Prishtine, Kosovo

Mario Vangjeli
Auditor Ligjor



NLB BANKA SH.A.
PASQYRA E POZITËS FINANCIARE
Më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënim	31 dhjetor 2021	31 dhjetor 2020
PASURITË			
Paraja dhe gjendja me Bankën Qendrore	4	134,038	169,346
Kreditë dhe paradhëniet për bankat	5	26,940	29,837
Kreditë dhe paradhëniet për klientët	6	634,530	559,223
Pasuritë financiare sipas vlerës së drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	7	118,980	102,710
Pasuritë tjera	8	1,651	2,743
Tatimi në të ardhura i parapaguar	25	-	268
Prona dhe pajisjet	9	10,405	10,957
E drejta e përdorimit të pasurive	9.1	2,369	2,515
Pasuritë e paprekshme	10	1,344	1,138
Tatimi i shtyrë	25	290	327
Gjithsej pasuritë		930,547	879,064
DETYRIMET			
Detyrimet ndaj bankave	11	558	1,172
Detyrimet ndaj klientëve	12	798,789	748,317
Detyrimet tjera financiare	13	10,296	8,693
Provizionet dhe detyrimet tjera	14	6,344	7,534
Tatimi i pagueshëm në të ardhurave të korporatës	25	695	-
Huamarrjet dhe borxhet e varura	16	15,008	15,013
Gjithsej detyrimet		831,690	780,729
EKUITETI I AKSIONARËVE			
Kapitali aksionar	17	51,287	51,287
Rezerva e ri-vlerësuar për letrat me vlerë sipas vlerës së drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse	26	1,442	1,753
Fitimi i pashpërndarë		46,128	45,295
Gjithsej ekuiteti		98,857	98,335
Gjithsej detyrimet dhe ekuiteti		930,547	879,064

Këto pasqyra financiare u miratuan nga Bordi Udhëheqës më 28 shkurt 2022 dhe janë nënshkruar në emër të tyre nga:


 Z. Albert Lumezi
 Drejtor Ekzekutiv


 Z. Gem Maloku
 Zëvendës Drejtor
 Ekzekutiv dhe Financiar


 Z. Visar Kabashi
 Drejtor i Divizionit të
 Financave

Shënimet e bashkangjitura nga faqe 10 deri 81 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NLB BANKA SH.A.
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBYES DHE TË ARDHURAVE GJITHËPËRFSHIRËSE
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021
(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Shënim	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020
Të hyrat nga interesi dhe të ngjashme	18	38,083	36,496
Shpenzimet e interesit dhe të ngjashme	19	(3,623)	(4,210)
Të hyrat neto nga interesi		34,460	32,286
Të hyrat nga tarifat dhe komisionet	20	13,423	11,204
Shpenzimet nga tarifat dhe komisionet	21	(4,619)	(3,501)
Neto të hyrat nga tarifat dhe komisionet		8,804	7,703
Shpenzimet e provizioneve për humbjet nga kreditë	4,5,6,7,8	(2,267)	(10,670)
Neto të hyrat operative		40,997	29,319
Të hyrat tjera operative	22	475	339
Shpenzimet tjera operative	22	(1,907)	(1,650)
Provizione tjera	15	1,204	(676)
Shpenzimet e personelit	23	(6,850)	(6,158)
Shpenzimet e zhvlerësimit dhe amortizimit	9,10	(2,242)	(2,030)
Shpenzimet administrative dhe të tjera operative	24	(4,453)	(4,099)
Fitimi para tatimit		27,224	15,045
Tatimi në fitim	25	(2,787)	(1,711)
Neto fitimi për vitin		24,437	13,334
Të hyrat tjera gjithëpërfshirëse /(humbja):			
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse që nuk do të riklasifikohen në pasqyrën e fitimit dhe humbjes			
Neto fitimet nga instrumentet e kapitalit në vlerë të drejtë të vlerës së drejtë të të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse		54	50
Gjithsej zërat që nuk do të riklasifikohen në pasqyrën e fitimit dhe humbjes		54	50
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse që do të riklasifikohen në pasqyrën e fitimit dhe humbjes			
Neto fitimet nga instrumentet e borxhit në vlerë të drejtë të vlerës së drejtë të të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse		(365)	24
Gjithsej zërat që do të riklasifikohen në pasqyrën e fitimit dhe humbjes		(311)	74
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin	26	(311)	74
Gjithsej të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse për vitin		24,126	13,408
Fitimet bazë dhe të holluar për aksion (në Euro për aksion)	27	572	312

Shënimet shpjeguese nga faqe 10 deri 81 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NLB BANKA SH.A.
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË EKUITET
Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

	Kapitali aksionar	Rezerva e vlerës së drejtë	Fitimi i pashpërndarë	Gjithsej
Gjendja më 1 janar 2020	51,287	1,679	31,961	84,927
Neto fitimi për vitin	-	-	13,334	13,334
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (Shënimi 26)	-	74	-	74
Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse për vitin	-	74	13,334	13,408
Gjendja më 31 dhjetor 2020	51,287	1,753	45,295	98,335
Neto fitimi për vitin	-	-	24,437	24,437
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë të pasurive financiare nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (Shënimi 26)	-	(311)	-	(311)
Gjithsej të hyrat gjithëpërfshirëse për vitin	-	(311)	24,437	24,126
Dividenda e paguar			(23,604)	(23,604)
Gjendja më 31 dhjetor 2021	51,287	1,442	46,128	98,857

Shënimet e bashkangjitura nga faqe 10 deri 81 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

NLB BANKA SH.A.
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË
Për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021

(Të gjitha shumat janë të paraqitura në mijë Euro, përveç nëse theksohet ndryshe)

Shënime	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2021	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi i vitit para tatimit	27,224	15,045
Zhvlerësimi dhe amortizimi	9,10	2,030
Shpenzimet e provizioneve për humbjet nga kreditë	4,5,6,7,8	10,670
Humbja nga shitja e pronës, impianteve dhe pajisjeve	-	11
Provizionet dhe humbjet e tjera	15	676
Të hyrat nga interesi	18	(36,496)
Shpenzimet e interesit	19	4,210
	(3,931)	(3,854)
Rritja në rezervën e detyrueshme me BQK	4.1	(7,368)
Zvogëlimi në kreditë dhe paradhëniet për bankat	5	1,854
Rritja në kreditë dhe paradhëniet për klientët	6	(77,554)
Zvogëlimi/(Rritja) në pasuritë tjera	8	128
(Rritja)/Zvogëlimi në detyrimet ndaj bankave	11	(614)
Rritja në detyrimet ndaj klientëve	12	50,472
Rritja/(Zvogëlimi) në detyrimet tjera financiare	13	1,603
Rritja/(Zvogëlimi) në detyrimet e tjera	14	30
	(35,380)	20,079
Interesi i arkëtuar		38,443
Interesi i paguar		(3,972)
Tatimi i paguar në të ardhura		(1,726)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative		(2,635)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Blerjet e pronave dhe pajisjeve	9	(689)
Shitjet e pronave dhe pajisjeve		-
Blerjet e pasurive të paprekshme	10	(594)
Blerjet e pasurive financiare sipas vlerës së drejtë përmes të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse	7	(64,873)
Të ardhurat nga maturimi i pasurive financiare në sipas vlerës së drejtë përmes të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse		48,675
Neto paraja e gatshme nga aktivitetet investuese		(17,481)
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financiare		
Pagesa e huazimeve	16	(5)
Pagesa e dividendës		(23,604)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet financiare		(23,609)
Rritja e parave të gatshme		(43,725)
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet më 1 janar	4.1	130,308
Paraja e gatshme dhe ekuivalentet e saj më 31 dhjetor	4.1	86,583

Shënimet e bashkangjitura nga faqe 10 deri 81 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. INFORMATA TË PËRGJITHSHME

NLB Banka Sh.a. është bankë komerciale ("Banka") e regjistruar në Regjistrin e Kosovës nën Çertifikatën e Regjistrimit nr. 70053484 të datës 18 dhjetor 2007. Banka është krijuar nga bashkimi i dy bankave, NLB Kasabank dhe Banka e Re e Kosovës (gjatë vitit 2007 të dy bankat ishin nën kontroll të Nova Ljubljanska Banka d.d.), dhe ka fituar licencën për aktivitete bankare më 19 dhjetor 2007 nga Banka Qendrore e Kosovës ("BQK").

Banka kontrollohet nga Nova Ljubljanska Banka d.d. Ljubljana me qendër në Slloveni (Banka mëmë), e cila posedon 82.38% të aksioneve të zakonshme sipas datës 31 dhjetor 2021 (2020: 81.21% të aksioneve të zakonshme). Nova Ljubljanska Banka d.d. Ljubljana është privatizuar në vitin 2018 dhe listuar në Bursën e Londrës. Më 31 dhjetor 2020, 75% pa një aksion, e Bankës tani është në pronësi të investitorëve ndërkombëtar që zotërojnë më pak se 10% secili, ndërsa Republika e Sllovenisë mbetet aksionari më i madh me 25% plus një aksion, të aksioneve.

Qendra e Bankës gjendet në Rr. Ukshin Hoti nr. 124, Prishtinë, Kosovë. Banka vepron si bankë komerciale për të gjitha kategoritë e klientëve, përmes rrjetit të saj me 9 degë në Prishtinë, Gjakovë, Pejë, Ferizaj, Mitrovicë, Gjiilan, Besianë, Prizren, dhe 25 nën-degë.

Banka më 31 dhjetor 2021 ka pasur 463 të punësuar (31 dhjetor 2020: 463). Pasqyrat financiare të Bankës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021 janë aprovuar nga Bordi Udhëheqës më 28 shkurt 2022.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

2.1 Deklarata e përputhshmërisë

Banka përgatitë pasqyrat e saj financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare të bankës për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 janë përgatitur në përputhje me SNRF, siç janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK) dhe trupi paraprak. Krahas kësaj, janë zbatuar interpretimet e publikuara nga Komiteti për Interpretimin e Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (KISNRF) dhe trupi paraprak.

Pasqyrat financiare sipas SNRF të bankës përbëhen nga pasqyrat e gjendjes financiare, pasqyrën e fitimit ose humbjes dhe të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimit në ekuitet, pasqyra e rrjedhës së parasë, politikat e rëndësishme kontabël dhe shënimet për pasqyrat financiare. Këto pasqyra financiare mbulojnë njësinë individuale, pasi që banka nuk është bankë mëmë.

2.2 Bazat e përgatitjes për pasqyrat financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e vijimësisë, nën marrëveshjen e kostos historike siç modifikohen nga rivlerësimi i pasurive financiare sipas vlerës së drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe pasuritë financiare dhe detyrimet financiare me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes, nëse ka ndonjë. Politikat kryesore kontabël janë të shpalosura më poshtë.

2.2.1 Parimi i vijimësisë

Menaxhmenti i Bankës ka bërë një vlerësim të aftësisë së saj për të vazhduar biznesin dhe operacionet e saj dhe është i kënaqur që ka burime të mjaftueshme për të vazhduar biznesin e saj për të ardhmen e parashikueshme. Për më tepër, menaxhmenti nuk është në dijeni të ndonjë pasigurie materiale që mund të hedhin dyshime të konsiderueshme mbi aftësinë e bankës për të vazhduar aktivitetin.

Shpërthimi i pandemisë COVID-19 dhe masat e miratuara nga Qeveria e Kosovës për të parandaluar përhapjen e saj kanë ndikuar në operacionet e Bankës, Banka është përgjigjur me një qasje të kujdesshme ndaj humbjeve të pritshme nga kreditë dhe ka bërë rritjen e vigjilencës ndaj monitorimit të portfolieve të kredisë. Banka ka vlerësuar ndikimin e pandemisë dhe përmes shfrytëzimit të rritjes së HPK dhe kostos së rrezikut ka reflektuar ndikimin negativ të pandemisë në performancën financiare të Bankës. Instrumentet e tjera financiare të mbajtur nga Banka nuk kanë shfaqur ndonjë rritje të ndjeshme të rrezikut të kredisë.

Kërkesa e tregut për kredi të reja dhe shërbime bankare ka rezultuar të jetë e fortë. Banka arriti të realizojë një nivel të kënaqshëm të fitimit, ka kapital të mjaftueshëm dhe mbrojtës të likuiditetit për të qëndruar likuide ndaj goditjeve të mundshme nga pandemia, e cila në Kosovë duket se ka filluar të qetësohet dhe masat kufizuese kanë filluar të zbuten.

Prandaj, pasqyrat financiare vazhdojnë të përgatiten mbi bazën e parimit të vijimësisë.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.2 Bazat e përgatitjes për pasqyrat financiare (vazhdim)

2.2.2 Vlerësimet dhe supozimet

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me SNRF kërkon përdorimin e vlerësimeve dhe supozimeve që ndikojnë në shumat e raportuara të pasurive dhe detyrimeve, dhe shpalosjen e pasurive dhe detyrimeve kontingjente në datën e pasqyrave financiare dhe shumat e raportuara të ardhurave dhe shpenzimeve gjatë periudhës së raportimit. Edhe pse këto vlerësime janë bazuar në njohuritë më të mira të ngjarjeve dhe aktiviteteve aktuale nga menaxhmenti, rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të parashikuara. Vlerësimet kontabël dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Vlerësimet e rëndësishme janë shpalosur në mënyrë më të detajuar në shënimet 2.27, 2.28, 2.30, 2.31, 2.32 dhe 2.33. Rishikimi i vlerësimeve njihet në mënyrë prospektive.

2.3 Të dhënat krahasuese

Përveç kur një standard apo një interpretim lejon apo e kërkon ndryshe, të gjitha shumat janë raportuar ose janë shpalosur me shumat krahasuese. Aty ku është e aplikueshme, shifrat krahasuese janë riklasifikuar për t'iu përshtatur ndryshimeve në paraqitjen në vitin aktual dhe janë shpalosur, në pasqyrën e fluksit të pasqyrës në aktivitetet investuese dhe në shënimin (Shënimi 4.1).

2.4 Valuta funksionale

Pasqyrat financiare janë të paraqitura në Euro, e cila është gjithashtu valuta funksionale e Bankës.

2.5 Të hyrat nga interesi dhe shpenzimet

Të ardhurat nga interesi dhe shpenzimet për të gjithë instrumentet financiarë të matur me koston e amortizuar, dhe pasuritë financiare të matura me vlerën e drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, njihen në pasqyrën e të ardhurave për të gjitha instrumentet e mbartjes së interesit mbi bazën akruale, duke përdorur metodën efektive të normës së interesit. Të ardhurat nga interesi për të gjitha pasuritë tregtare dhe pasuritë financiare që detyrimisht kërkohen të maten me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes njihen duke përdorur normën e interesit kontraktuale

Metoda efektive e normës së interesit përdoret për të llogaritur koston e amortizuar të një pasurie financiare ose një detyrim financiar dhe për të shpërndarë të ardhurat nga interesi ose shpenzimet e interesit gjatë periudhës përkatëse. Norma efektive e interesit është ajo normë që zbrit saktësisht pagesat e arkëtimeve të ardhshme ose arkëtimet gjatë jetës së pritshme të instrumentit financiar, ose një periudhe më e shkurtër (kur është e përshtatshme) në vlerën neto kontabël të pasurisë financiare ose detyrimit financiar. Të ardhurat nga interesi përfshijnë kuponë të fituar nga investimet me rendimente fikse dhe letra me vlerë të tregtimit, dhe zbritje të vlerësuar dhe prime të letrave me vlerë. Llogaritja e normës efektive të interesit përfshin të gjitha tarifat dhe pikat e paguara ose të marra nga palët në kontratë dhe të gjitha kostot e transaksionit, por përjashton humbjet e rrezikut të kredisë në të ardhmen.

Të ardhurat nga interesi llogariten duke aplikuar normën efektive të interesit në vlerën kontabël bruto të pasurive financiare, përveç pasurive me rënie në vlerë, në të cilin rast aplikohet mbi vlerën kontabël neto.

2.6 Tarifat dhe komisionet

Të hyrat nga tarifat e komisionet dhe shpenzimet që rrjedhin nga dhënia, respektivisht përdorimi i shërbimeve bankare janë regjistruar në fitim dhe humbje siç kanë ndodhur, në momentin kur janë përfshirë shërbimet, respektivisht kur janë përdorur ato.

Tarifat e menaxhimit të kredive që ka gjasa të tërhiqen deri në fund janë shtyrë (së bashku me kostot direkt të lidhura) dhe regjistrohen si një korrigjim i normës efektive të interesit të kredisë.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet përfshijnë gjithashtu pagesat nga letër garancionet dhe letërkreditë e lëshuara nga Banka në favor të klientëve, detyrimet e pagesave që rrjedhin nga bankat vendore dhe ndërkombëtare, dhe shërbimet tjera të ofruara nga Banka.

2. PËRMBLEDHJA E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.7 Instrumentet Financiare

a) Klasifikimi dhe matja

Nga perspektiva e klasifikimit dhe matjes, SNRF 9 kërkon që të gjitha pasuritë financiare të borxhit të vlerësohen në bazë të një kombinimi të modelit të biznesit për menaxhimin e pasuritë dhe karakteristikat e rrjedhave monetare kontraktuale të instrumenteve. Kategoritë e matjes së pasurive financiare janë si më poshtë:

- Pasuritë financiare, të matura me kostot e amortizuara (AC),
- Pasuritë financiare me vlerë të tregut përmes të ardhurave të tjera përmbledhëse (FVOCI),
- Pasuritë financiare të mbajtura për tregtim (FVTPL); dhe
- Pasuritë financiare jo-tregtare, detyrimisht me vlerë të tregut nëpërmjet fitimit ose humbjes (FVTPL).

Pasuritë financiare maten me koston e amortizuar nëse ato mbahen brenda një modeli biznesi me qëllim të grumbullimit të rrjedhave monetare ('mbahen për të mbledhur dhe shitur'), dhe nëse rrjedhat e parave janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të papaguar.

Instrumentet financiare të borxhit maten në FVOCI nëse ato mbahen brenda një modeli biznesi me qëllim të mbledhjes së rrjedhave monetare kontraktuale dhe shitjes ('të mbajtura për të mbledhur dhe shitur'), dhe nëse rrjedhat e parave janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit të principalit shuma e papaguar. FVOCI rezultojnë që instrumentet e borxhit të njihen me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar dhe në koston e amortizuar në pasqyrën e të ardhurave. Fitimet dhe humbjet, përveç humbjeve të pritura të kredisë dhe transaksioneve me valuta të huaja, njihen në të ardhurat të tjera gjithëpërfshirëse deri në çregjistrimin e instrumentit. Në çregjistrimin e instrumentit financiar të borxhit, fitimet dhe humbjet kumulative të njohura më parë në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse, riklasifikohen në pasqyrën e të ardhurave.

Instrumentet e kapitalit që nuk mbahen për tregti mund të përcaktohen në mënyrë të pakthyeshme si FVOCI, pa ndonjë riklasifikim të mëpasshëm të fitimeve ose humbjeve në pasqyrën e të ardhurave, përveç për dividendët që njihen në pasqyrën e të ardhurave.

Të gjitha pasuritë e tjera financiare maten në FVTPL, duke përfshirë pasuritë financiare brenda modeleve të tjera të biznesit, siç janë pasuritë financiare të menaxhuara me vlerën e drejtë ose që mbahen për tregti dhe pasuritë financiare me rrjedhat monetare kontraktuale që nuk janë vetëm pagesa të principalit dhe interesit mbi shumën kryesore të mbetur.

SNRF 9 përfshin një mundësi për të përcaktuar pasuritë financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes nëse kjo bën që të eliminojë ose zvogëlojë ndjeshëm një mospërputhje të matjes ose njohjes që do të lindte ndryshe nga matja e pasurive ose detyrimeve ose njohja e fitimeve ose humbjeve mbi to në baza të ndryshme.

Kontabiliteti për detyrimet financiare mbeti gjerësisht i njëjtë me kërkesat e SNK 39, përveç trajtimit të fitimeve ose humbjeve që rrjedhin nga rreziku i kredisë së vetë bankës në lidhje me detyrimet e përcaktuara në FVTPL. Lëvizje të tilla paraqiten në OCI pa ndonjë riklasifikim pasues të pasqyrës së të ardhurave.

Vlerësimi i modelit të biznesit të Bankës

Banka ka përcaktuar modelin e saj të biznesit veç e veç për secilën njësi raportuese dhe bazohet në faktorë vëzhgues për portofole të ndryshme që reflektojnë më së miri se si Banka administron grupe të pasurive financiare për të arritur objektivin e saj të biznesit, siç janë:

- Si vlerësohet dhe raportohet performanca e modelit të biznesit dhe pasurive financiare të mbajtura brenda atij modeli biznesi të personelit drejtues të njësisë ekonomike;
- Risqet që ndikojnë në ecurinë e modelit të biznesit dhe, në veçanti, mënyrën se si menaxhohen ato risqe;
- Si kompensohen menaxherët e biznesit (për shembull, nëse kompensimi bazohet në vlerën e drejtë të pasurive të administruara ose në mjetet kontraktuale të arkëtuara);
- Frekuenca e pritshme, vlera dhe koha e shitjes.

2. POLITIKAT E RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

2.7 Instrumentet Financiare (vazhdim)

a) Klasifikimi dhe matja (vazhdim)

Vlerësimi i modelit të biznesit bazohet në skenarë të pritshëm në mënyrë të arsyeshme, pa marrë parasysh skenarët e rasteve më të këqija. Në përgjithësi, vlerësimi i modelit të biznesit të Bankës mund të përmbledhet si më poshtë:

- kreditë dhe depozitat e dhëna përfshihen në një model biznesi "për mbledhje" pasi qëllimi kryesor i Grupit NLB për portofolin e kredisë është mbledhja e rrjedhave monetare kontraktuale.
- letrat me vlerë të borxhit ndahen në tre modele biznesi:
- grupi i parë i letrave me vlerë të borxhit paraqet "kategorinë e tregtimit"
- grupi i dytë i letrave me vlerë të borxhit mbahet nën një model biznesi "të mbajtur për të mbledhur dhe shitur" me qëllim të mbledhjes së rrjedhave monetare të kontratës dhe shitjes së pasurive financiare, dhe është pjesë e rezervave të likuiditetit të Grupit;
- pjesa e tretë e letrave me vlerë të borxhit mbahet në modelin e biznesit për mbajtjen e tyre në mënyrë që të mbledhin rrjedhat monetare kontraktuale.

